
Rezultatet e anketës së vlerësimit të stafit administrativ për institucionin për vitin akademik 2022-2023

Anketës i janë përgjigjur vetëm 11 anëtarë të stafit administrativ. Vlerësimi më poshtë është bërë në bazë të katër (4) të seksioneve me pohime të organizuara sipas shkallës Likert, dhe një (1) seksioni me sugjerime.

A. Shërbimet e ofruara në institucion

45.5% e stafit administrativ janë të kënaqur me ambientin dhe hapësirat e ofruara në punë, 45.5% janë pjesërisht të kënaqur dhe 9% nuk janë të kënaqur.

Për afërsisht 73% të anëtarëve të stafit administrativ, kushtet higjieno-sanitare janë të kënaqshme ose plotësisht të kënaqshme, dhe për 27% të anëtarëve janë pjesërisht të kënaqshme. Asnjë anëtar nuk shpreh pakënaqësi totale me kushtet higjieno-sanitare.

Shërbimet e ofruara në lidhje me sistemin e sigurisë janë në nivele të kënaqshme për 45.5% të stafit, 18% e tyre janë pjesërisht të kënaqur dhe afërsisht 36.5% e tyre nuk janë të kënaqur me këtë sistem sigurie.

Shërbimet teknologjike dhe sistemi informativ BIS janë të kënaqshme për me shumë se gjysmën e pjesëmarrësve (72.7% të kënaqur me shërbimet teknologjike, 54.5% të kënaqur me sistemin BIS), pjesërisht të kënaqur janë 18.2%-27% e pjesëmarrësve, jo të kënaqur janë 9% e stafit me shërbimet teknologjike dhe 18.2% e tyre me sistemin BIS.

Afërsisht 55% e stafit mendojnë se janë të informuar në lidhje me zhvillimet në institucion, 18.2% mendojnë se informimi është i pjesshëm dhe 27.3% e tyre mendojnë se ka një mungesë informimi. Për sa i takon kohës së informimit, 36.4% mendojnë se informimi bëhet në kohë, 36.4% janë të mendimit se informimi bëhet pjesërisht në kohën e duhur, 27.3% mendojnë se informimi nuk bëhet në kohën e duhur.

Pothuajse 100% nga pjesëmarrësit janë shumë të kënaqur dhe të kënaqur me ushqimin e ofruar në institucion.

Si përfundim, pjesa më e madhe e stafit është në përgjithësi e kënaqur me shërbimet e ofruara, kryesisht me kushtet higjeno-sanitare, ushqimin dhe shërbimet teknologjike. Shërbimi që mund të merret në konsideratë për përmirësim janë hapsirat e punës.

B. Bashkëpunimi në departament dhe në institucion

Lidhur me bashkëpunimin midis njësive dhe zyrave dhe fakultetit 27.3% e pjesëmarrësve të stafit administrativ janë plotësisht të kënaqur, 54.5% janë të kënaqur ndërsa 18.2% të stafit administrativ nuk janë të kënaqur.

27.3% e stafit administrativ mendojnë se në fakultet ekziston fryma e bashkëpunimit, 63.6% mendojnë se ekziston pjesërisht fryma e bashkëpunimit dhe 9.1% mendojnë se fryma e bashkëpunimit nuk ekziston.

27.3% e stafit administrativ mendojnë se në departament ekziston fryma e bashkëpunimit dhe 72.7% mendojnë se ekziston pjesërisht.

Në lidhje me bashkëpunimin midis stafit akademik dhe administrativ rezulton se pjesëmarrësit janë 36.4% të kënaqur, 54.5% janë pjesërisht të kënaqur dhe 9.1% shprehen të pa kënaqur.

Për sa i përket sugjerimeve midis stafit administrativ, afërsisht 46% mendojnë se sugjerimet e tyre merren parasysh nga pjesa tjetër e stafit, 18% mendojnë se sugjerimet e tyre merren parasysh pjesërisht dhe 36% mendojnë se sugjerimet e tyre nuk merren parasysh.

Si përfundim, sipas pjesëmarrësve në anketë, në institucion ekziston fryma e bashkëpunimit. Për sa i përket marrjes parasysh të sugjerimeve, mbi 2/3 mendojnë se mendimet e tyre merren parasysh dhe pak më pak se 1/3 mendojnë se nuk merren parasysh.

C. Politikat dhe menaxhimi i institucionit

Për sa i përket menaxhimit dhe drejtimit të institucionit, 36.4% shprehen të kënaqur, 18.2% e pjesëmarrësve shprehen pjesërisht të kënaqur, ndërsa 45.5% nuk janë të kënaqur me organet drejtuese.

45.5% e stafit administrativ mendojnë se ankesat përcillen me lehtësi në organet eprore, 18.2% e pjesëmarrësve mendojnë se përcilen pjesërisht dhe 36.4% mendojnë se ankesat e tyre nuk përcillen në organet eprore.

Lidhur me përfshirjen në vendim-marrje të stafit administrativ, 18.2% mendojnë se janë të përfshirë, 54.5 % mendojnë se janë pjesërisht të përfshirë ndërsa 27.3% mendojnë se nuk janë të përfshirë.

36.4% e pjesëmarrësve janë të kënaqur me politikat dhe mbarëvajtjen institucionale, 36.4% janë pjesërisht të kënaqur dhe 27.3% nga anëtarët e stafit nuk janë aspak të kënaqur me politikat institucionale.

Në lidhje me mbështetjen e mendimeve inovative dhe prurjeve të reja, 45.5% e stafit administrativ janë të kënaqur, 27.3% janë pjesërisht të kënaqur dhe 27.3% nuk janë aspak të kënaqur.

Vetëm 18.2% e pjesëmarrësve mendojnë se trajtimi i stafit bëhet në mënyrë të barabartë, 18.2% mendojnë pjesërisht dhe më shumë se gjysma e pjesëmarrësve (63.7%) mendojnë se trajtimi i stafit nuk bëhet në mënyrë të barabartë.

Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve janë dakord se studentët përbëjnë përparësi për institucionin dhe janë dakord se marrëdhëniet mes stafit dhe studentit janë shumë të mira (72.8%), 27.3% e tyre janë pjesërisht dakord për dy pikat e përmendura më sipër.

Për sa i përket mundësisë për zhvillimin profesional vihet re raporti me 36.4% të kënaqur, 27.3% pjesërisht të kënaqur, 18.2% jo të kënaqur dhe 18.2% aspak të kënaqur.

Në lidhje me nxitjen e stafit për kërkimin shkencor dhe praktikave profesionale 54.6% të pjesëmarrësve janë të kënaqur, 27.3% janë pjesërisht të kënaqur dhe 18.2% nuk janë të kënaqur.

Për sa i përket rëndësisë që institucioni i kushton ndërkombëtarizimit pjesa më e madhe e pjesëmarrësve (63.7%) janë të kënaqur, 18.2% janë pjesërisht dakord, ndërsa 18.2 % nuk mendon se institucioni bën mjaftueshëm për ndërkombëtarizimin.

63.7% e pjesëmarrësve në anketë mendojnë se institucioni u kushton shumë rëndësi programeve të shkëmbimit. 18.2% e tyre mendojnë se institucioni u kushton pjesërisht rëndësi programeve të shkëmbimit dhe 18.2% mendojnë se institucioni nuk u kushton aspak rëndësi këtyre programeve.

Si përfundim, vihet re se mbi 50% e stafit pjesëmarrës në anketë është i kënaqur me drejtimin dhe menaxhimin e institucionit. sipas pjesëmarrësve, drejtimi i institucionit u kushton rëndësi mendimeve inovative dhe zhvillimit profesional të stafit.

D. Ngarkesa dhe vlerësimi i punës

45.5% e pjesëmarrësve janë të qartë për punën që bëjnë dhe përgjegjësitë që kanë, 36.4% e tyre janë pjesësisht të qartë dhe 18.2% e tyre nuk janë të qartë.

Ndërkohë që 27.3% mendojnë se ngarkesa e tyre është e përballueshme, 63.7%, pra më shumë se gjysma e pjesëmarrësve mendojnë se ajo nuk është e përballueshme dhe 9.1% mendojnë se kanë ngarkesë pjesërisht të përballueshme. Në lidhje me vlerësimin për punën që bëjnë, 36.4% ndihen të vlerësuar, 27.3% disi të vlerësuar dhe 36.4% nuk ndihen të vlerësuar për punën që bëjnë.

Në total, 54.6% e pjesëmarrësve janë të kënaqur që punojnë në KU Bedër dhe 45.5 % e tyre janë disi të kënaqur.

Si përfundim, mund të thuhet se 63.7% e stafit administrativ pjesëmarrës në anketë mendon se kanë mbingarkesë në punë.

E. Sugjerimet

Pyetjes në lidhje me sugjerimet u janë përgjigjur vetëm katër pjesëmarrës, përgjigjet e të cilëve janë si më poshtë:

1. Të organizohen më shumë mbledhje mbi mbarëvajtjen e stafit administrativ dhe prezantimin e problematikave.
2. Bashkëpunim dhe qasje pozitive me administratën, burime njerëzore për të përballuar ngarkesën.
3. Mirëorganizim, vlerësim i punonjësve me eksperiencë, fokusim në realizimin e objektivave.

Përfundime

Pas analizës së përgjigjeve për çdo pyetje dhe seksion të pyetësorit lidhur me shërbimet që ofron institucioni në mbështetje të mbarëvajtjes të proceseve të ndryshme gjatë vitit akademik, NJSBC bën këto rekomandime

- 1. Të shihen mundësitë për shtimin e hapësirave të punës.**
- 2. Të punohet për të rritur frymën e bashkëpunimit. T'i mëshohet përfshirjes më të gjerë të stafit administrativ në vendim-marrje në fakultet apo departament.**
- 3. Të punohet më shumë në përçimin e ankesave, mënyrën e menaxhimit dhe rregullimin e politikave.**
- 4. Të shihen mundësitë e shtimit të programeve të shkëmbimit për stafin administrativ.**